

## Vendim nr. 227 datë 01.11.2023

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Holta Zaçaj,	Kryetare
Sonila Bejtja,	Anëtare
Fiona Papajorgji,	Anëtare

në datën 01.11.2023 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 42 (A) 2023 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

**KËRKUES:** ALEKSANDËR LEKA

**OBJEKTI:** Shfuqizimi i vendimeve nr. 10-2017-1466 (452), datë 08.06.2017 të Gjykatës së Apelit Durrës; nr. 00–2023–384, datë 02.03.2023 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 4, pika 1, 6, 33, pika 1, 42, 43, 124, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ); ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (ligji nr. 8577/2000).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatoren e çështjes Fiona Papajorgji, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

**V Ë R E N:**

**I**

**Rrethanat e çështjes**

1. Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës ka dërguar për gjykim pranë kësaj gjykate procedimin penal nr. 60 të vitit 2015 në ngarkim të të pandehurit Aleksandër Leka (*kërkuesi*), i akuzuar për kryerjen e veprës penale “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe municionit”, të parashikuar nga neni 278, paragrafi 3, i Kodit Penal (*KP*).

2. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, me vendimin nr. (11-2015-6228) 1264, datë 22.12.2015, ka vendosur deklarinimin të pafajshëm të kërkuesit për kryerjen e veprës penale për të cilën ishte akuzuar, pasi nuk provohej që ai ta kishte kryer atë. Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.

3. Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr. 10-2017-1466 (452), datë 08.06.2017, ka vendosur ndryshimin e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, deklarinimin fajtor të kërkuesit për veprën penale të parashikuar nga neni 278, paragrafi 3, i KP-së dhe dënimin e tij me 2 (dy) vjet burgim, vuajtja e të cilit fillonte nga dita e ekzekutimit të vendimit. Kundër këtij vendimi ka ushtruar rekurs kërkuesi.

4. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00–2023–384, datë 02.03.2023, ka vendosur mospranimin e rekursit, me arsyetimin se shkaqet e paraqitura në të nuk ishin të tilla që të cenonin vendimmarrjen e gjykatës së apelit, nuk kishte mosrespektim ose zbatim të gabuar të ligjit penal nga kjo gjykatë dhe, për rrjedhojë, nuk ndodhej në asnjë nga rastet e parashikuara nga neni 432 i Kodit të Procedurës Penale (*KPP*).

5. Kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) në datën 11.09.2023 me ankim kushtetues individual, duke kërkuar shfuqizimin e vendimit të gjykatës së apelit dhe të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

## II

### Pretendimet e kërkuesit

6. *Kërkuesi*, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i janë cenuar:

6.1. E drejta për proces të rregullt ligjor, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së, në drejtim të:

6.1.1. *Standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor*, pasi vendimi i gjykatës së apelit nuk përmbush kriteret e një vendimi gjyqësor. Atij i mungon arsyetimi i drejtë, objektiv dhe logjik, për shkak të kontradiktave të shumta dhe mungesës së unitetit ndërmjet përmbajtjes dhe logjikës objektive në përcaktimin e fajësisë së kërkuesit. Në vendim mbizotëron subjektivizmi në analizën e provave, duke mos i marrë në

shqyrtim ato që janë në favor të tij. Përfundimet e kësaj gjykate nuk kanë asnjë forcë bindëse, pasi ato nuk bazohen në prova konkrete e të analizuara në mënyrë të individualizuar. Po kështu, edhe vendimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë është i paarsyetuar dhe ka mungesë argumentimi, si për sa i përket mospranimit të rekursit, ashtu dhe për rrethanat mbi të cilat janë dhënë vendimet e gjykatave. Pretendimet e ngritura në rekurs duhet të dëgjoheshin dhe të diskutoheshin nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë. Rekursi parashtronte qartë shkaqet ligjore dhe pretendimet për një gjykim të padrejtë dhe të paligjshëm, ndaj shqyrtimi i tij në dhomën e këshillimit nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, duke dalë me një vendim të paarsyetuar, ka cenuar edhe *të drejtën e tij të mbrojtjes*.

- 6.1.2. Në procesin gjyqësor pranë gjykatës së apelit ka marrë pjesë prokurorja e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, që kishte kryer përfaqësim të akuzës edhe në procesin gjyqësor të zhvilluar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës, fakt që përbën shkelje të rëndë të dispozitave procedurale penale.
- 6.2. *Parimi i mosrëndimit të pozitës së të pandehurit*, pasi gjykata e apelit nuk e ka përsëritur shqyrtimin gjyqësor, në zbatim të nenit 427, paragrafi 4, të KPP-së. Një kërkesë e tillë nuk është paraqitur as nga ana e prokurorisë, as nuk është ndërmarrë kryesisht nga vetë gjykata. Ky veprim i kundërligjshëm është bërë nga nxitimi për të shpallur kërkuesin fajtor, pavarësisht mungesës së provave. Përsëritja e shqyrtimit gjyqësor është kusht ligjor për procesin e rregullt ligjor dhe cenimi i këtij detyrimi e bën vendimin të kundërligjshëm. Kërkuesi është akuzuar për veprën penale të parashikuar nga neni 278, paragrafi 3, i KP-së, kur është fakt i ditur se banesa nuk është ambient publik. Organi i akuzës e ka paragjykuar hapur kërkuesin, duke i vlerësuar veprimet e tij si kriminale, ndërkohë që ka mbrojtur shtetasen L.B., duke e përgatitur këtë të fundit në përgjimin ambiental për të provuar fajësinë e tij.
- 6.3. *Parimi i prezumimit të pafajësisë*, i garantuar në nenin 30 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së, pasi mënyra e arsyetimit e vendimeve të gjykatës së apelit dhe Gjykatës së Lartë krijojnë dyshimin se procesi gjyqësor në gjykatën e apelit ka filluar me bindjen se kërkuesi e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet. Në arsyetimin e vendimit të saj gjejnë vend vetëm provat e cilësuar prej saj si prova fajësie dhe nuk është shprehur për provat e tjera të pretenduara nga mbrojtja, duke rënë ndesh me parashikimin e neneve 8/a dhe 152 të KPP-së. Sipas mendimit të pakicës së trupit

gjkues të gjykatës së apelit, organi i akuzës nuk ka arritur të provojë akuzën ndaj kërkuessit. Organi i prokurorisë ka paraqitur plotësim ankimi, përmbajtja e të cilit hedh dyshime për kryerjen e veprës penale prej kërkuessit. Kjo shprehet në kërkesën e organit të akuzës, ku me pretendimin se ka shkelje procedurale ka kërkuar prishjen e vendimit dhe kthimin e akteve gjykatës për rigjykim dhe nëse kjo nuk pranohej, kërkohej ndryshimi i vendimit. Kërkuessi ka bërë kallëzim tek organi i prokurorisë, duke dhënë informacion të mjaftueshëm për marrjen e një personi konkret si të pandehur. Në vend që të mbrohej nga ligji, kërkuessi është konsideruar kriminel dhe është marrë në përgjegjësi penale.

### III

#### Vlerësimi i Kolegjit

##### A. Për legjitimitimin e kërkuessit

7. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është vlerësuar nga Gjykata si një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

8. Për sa i përket përmbushjes së këtyre kriterëve, Kolegji vlerëson se kërkuessi legjitimohet *ratione personae*, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në procesin gjyqësor ndaj të cilit ka ngritur pretendime në këtë Gjykatë dhe ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

9. Një kriter tjetër paraprak është *shterimi i mjeteve juridike efektive*, që përcaktohet nga neni 131, pika 1, shkronja “f”, i Kushtetutës, sipas të cilit individ mund t’i drejtohet Gjykatës me ankim kushtetues individual, vetëm pasi të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese që ai pretendon se i janë cenuar. Ky rregull nënkupton jo vetëm që individ t’u jetë drejtuar të gjitha instancave të zakonshme, duke respektuar kërkesat

formale dhe afatet e parashikuara në ligjin procedural, por edhe që të gjitha pretendimet që ngrenë në këtë Gjykatë t'i ketë paraqitur më parë në këto instanca, të paktën në substancë (*shih vendimet nr. 14, datë 21.06.2022; nr. 12, datë 09.03.2021; nr. 8, datë 19.03.2018 të Gjykatës Kushtetuese*).

10. Në drejtim të përmbushjes së këtij kriteri, Kolegji vëren se pretendimi për cenimin e parimit të mosrëndimit të pozitës së të pandehurit nuk është ngritur në rekursin e kërkuarit, prandaj ky i fundit nuk ka shteruar mjetet ligjore në dispozicion, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës për këtë pretendim. Pretendimet e tjera, që kanë të bëjnë me cenimin e procesit të rregullt ligjor në drejtim të *standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor*, të garantuar nga nenet 42 dhe 142 të Kushtetutës, shkeljeve procedurale si pasojë e përfaqësimit të akuzës në gjykatën e apelit nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, si dhe *parimin e prezumimit të pafajësisë*, të garantuar nga neni 30 i Kushtetutës, kërkuari i ka ngritur, në thelb, në rekurs ose janë pretendime ndaj procesit gjyqësor në Gjykatën e Lartë, prandaj për to kërkuari ka shteruar mjetet juridike efektive në dispozicion përpara se t'i drejtohet Gjykatës.

11. Lidhur me legjitimitimin *ratione temporis*, neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i ligjit nr. 8577/2000 ka parashikuar afatin 4-mujor nga konstatimi i cenimit për paraqitjen e ankimit kushtetues individual. Në rastin në shqyrtim konstatohet se procesi gjyqësor i kundërshtuar nga kërkuari ka përfunduar me vendimin nr. 00–2023–384, datë 02.03.2023 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, ndërkohë që ankimi kushtetues individual është paraqitur dhe regjistruar në Gjykatë në datën 11.09.2023. Bazuar në aktet e depozituara në dosje, Kolegji vëren se vendimi gjyqësor i Gjykatës së Lartë i është komunikuar kërkuarit në adresën elektronike të kontaktit në datën 22.05.2023. Në këto rrethana, Kolegji vlerëson se kërkesa është depozituar brenda afatit ligjor 4-mujor sipas nenit 71/a, pika 1, shkronja “b”, i ligjit nr. 8577/2000.

12. Në drejtim të legjitimitimit *ratione materiae*, Kolegji thekson se sipas nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, si dhe nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, kontrolli kushtetues ndaj vendimeve gjyqësore është i kufizuar vetëm në funksion të mbrojtjes së të drejtave dhe lirive themelore të garantuara në Kushtetutë, kur pasojat negative janë të drejtpërdrejta dhe reale për kërkuarin dhe kur shqyrtimi kushtetues i çështjes mund të rivendosë të drejtën kushtetuese të shkelur.

13. Kolegji vëren se në çështjen konkrete, kërkuari, ndër të tjera, ka pretenduar se në procesin gjyqësor pranë gjykatës së apelit ka marrë pjesë prokurorja e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, që kishte kryer përfaqësim të akuzës edhe në procesin

gjqësor të zhvilluar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës, fakt që përbën shkelje të rëndë të dispozitave procedurale penale.

14. Duke iu referuar përmbajtjes së vendimit të Gjykatës së Apelit Durrës, Kolegji vëren se Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës përfaqëson akuzën në procesin gjyqësor penal ndaj kërkuesit edhe në gjykatën e apelit, me autorizim të lëshuar nga Prokuroria e Apelit Durrës. Ky përfaqësim është kryer në bazë të nenit 408, pika 2, të KPP-së, i cili në kohën e shqyrtimit të çështjes në apel parashikonte: *“Ankimi mund të bëhet edhe nga prokurori i seancës, i cili në këtë rast mund të marrë pjesë në gjykatën e apelit me autorizimin e prokurorit pranë kësaj gjykate.”*. Në këto rrethana, Kolegji vlerëson se përfaqësimi i kryer nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës në Gjykatën e Apelit Durrës ka qenë i legjitimuar sipas legjislacionit të kohës kur është zhvilluar gjykimi i çështjes, prandaj ky pretendim i kërkuesit nuk mund të merret në shqyrtim.

15. Për sa u takon pretendimeve të tjera që lidhen me cenimin e së drejtës për një proces të rregull ligjor në drejtim të *standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor dhe parimit të prezumimit të pafajësisë*, Kolegji çmon se ato *prima facie* hyjnë në juridiksionin kushtetues, ndaj do të analizohen në vijim.

#### *B. Për pretendimin e cenimit të standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor*

16. Kërkuesi ka pretenduar se vendimi i gjykatës së apelit nuk përmbush kriteret e një vendimi gjyqësor. Atij i mungon arsytimi i drejtë, objektiv dhe logjik, për shkak të kontradiktave të shumta dhe mungesës së unitetit ndërmjet përmbajtjes dhe logjikës objektive në përcaktimin e fajësisë së kërkuesit. Në vendim mbizotëron subjektivizmi në analizën e provave, duke mos i marrë në shqyrtim ato që janë në favor të tij. Përfundimet e kësaj gjykate nuk kanë asnjë forcë bindëse, pasi ato nuk bazohen në prova konkrete e të analizuara në mënyrë të individualizuar. Po kështu, edhe vendimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë është i paarsyetuar dhe ka mungesë argumentimi, si për sa i përket mospranimit të rekursit, ashtu dhe për rrethanat mbi të cilat janë dhënë vendimet e gjykatave. Pretendimet e ngritura në rekurs duhet të dëgjoheshin dhe të diskutoheshin nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë. Rekursi parashtronte qartë shkaqet ligjore dhe pretendimet për një gjykim të padrejtë dhe të paligjshëm, ndaj shqyrtimi i tij në dhomën e këshillimit nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, duke dalë me një vendim të paarsyetuar, ka cenuar edhe *të drejtën e tij të mbrojtjes*.

17. Gjykata ka pohuar se e drejta për një proces të rregullt ligjor përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës. Arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë dhe në këtë drejtim vendimi gjyqësor, në çdo rast, duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje. Në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre dhe ato duhet të jenë në shërbim dhe funksion të njëra-tjetrës. Argumentet e pjesës arsyetuese duhet të jenë të bazuara dhe të lidhura logjikisht, duke respektuar rregullat e mendimit të drejtë, dhe duhet të formojnë një përmbajtje koherente brenda vendimit, i cili përjashton çdo kundërthënie ose kontradiksion të hapur ose të fshehtë. Gjithashtu, detyrimi për garantimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor nuk nënkupton se kërkohet arsyetim i detajuar për çdo pretendim të palëve ndërgjyqëse, por ai varet nga natyra e vendimit në fjalë, ndërsa për sa i përket arsyetimit të vendimeve të Gjykatës së Lartë në dhomën e këshillimit, Gjykata ka theksuar se një arsyetim i kufizuar i vendimit nuk e cenon procesin e rregullt ligjor, pasi kjo formë arsyetimi shpreh në thelb shkaqet e mospranimit të rekursit nga ana e kolegjeve të Gjykatës së Lartë gjatë shqyrtimit të tij paraprak (*shih vendimet nr. 13, datë 21.03.2023; nr. 19, datë 07.07.2022; nr. 80, datë 18.12.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Gjithashtu, në jurisprudencën kushtetuese është theksuar se nuk është detyrë e Gjykatës të analizojë provat dhe faktet ku është bazuar gjykata e juridiksionit të zakonshëm për zgjidhjen e çështjes së themelit, pasi kjo mbetet detyrë funksionale e këtyre gjykatave (*shih vendimet nr. 17, datë 23.03.2023; nr. 19, datë 07.07.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Duke iu kthyer rastit konkret, konstatohet se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës ka vendosur deklarimin të pafajshëm të kërkuesit për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 278, paragrafi 3, i KP-së, me arsyetimin se nga provat e shqyrtuara gjatë gjykimit akuza nuk ka arritur të provojë që ai ka kryer veprën penale për të cilën akuzohej (*shih vendimin nr. (11-2015-6228) 1264, datë 22.12.2015 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, faqja 3*). Gjykata e Apelit Durrës ka vendosur ndryshimin e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, duke e deklaruar kërkuesin fajtor për këtë vepër penale dhe duke e dënuar me 2 (dy) vjet burgim. Kjo gjykatë ka arsyetuar se në ndryshim me përfundimet e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, provohej tej çdo dyshimi se kërkuesi ka kryer veprën penale për të cilën akuzohej. Nga provat e administruara në gjykim, ato materiale, shkresore dhe me dëshmitarë, është arritur në përfundimin se arma e gjetur i përkiste kërkuesit dhe ishte vendosur në banesë nga ai. Më tej, gjykata e apelit është ndalur në analizën e provave të administruara në gjykim dhe, në përfundim, ajo ka vlerësuar

se të gjitha provat kanë lidhje logjike me njëra-tjetrën dhe kërkuesi duhej të deklarohej fajtor për veprën penale që ai ka kryer (*shih vendimin nr. 10-2017-1466 (452), datë 08.06.2017 të Gjykatës së Apelit Durrës, faqet 5-6*).

20. Gjykata e Lartë edhe pse ka konstatuar se ka qëndrime të ndryshme lidhur me përgjegjësinë penale të kërkuesit, ka arritur në përfundimin se vendimi i gjykatës së apelit është i drejtë dhe se pretendimet e tij nuk janë të tilla që të cenojnë këtë vendim. Po kështu, kjo gjykatë ka vlerësuar se shkaqet e paraqitura në rekurs nuk përfshihen në asnjë nga rastet e parashikuara nga neni 432 i KPP-së.

21. Nga sa më lart, në analizë të vendimeve objekt shqyrtimi, Kolegji vlerëson se vendimet e gjykatës së apelit dhe të Gjykatës së Lartë në tërësinë e tyre paraqiten, logjike, të rregullta në formë, si dhe nuk rezultojnë të kenë paqartësi në përmbajtje. Pjesët hyrëse, ato arsytuese dhe dispozitivët e vendimeve objekt gjykimi vlerësohen në unitet dhe harmoni me njëra-tjetrën. Po kështu, vendimet nuk shfaqin pamjaftueshmëri lidhur me thelbin e pretendimeve të kërkuesit, ndërsa arsyetimi i kufizuar i vendimit të Gjykatës së Lartë është në përputhje me standardet e gjykatës për këto lloj vendimesh. Për sa më lart, vlerësohet se të dyja vendimet e kundërshtuara i përmbushin kriteret në drejtim të standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor.

22. Përveç sa më lart, Kolegji konstaton se pretendimi i kërkuesit për cenimin e standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor, në thelb, ka të bëjë me vlerësimin e provave nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, i cili, sikurse u theksua më sipër, nuk hyn në juridiksionin kushtetues. Për rrjedhojë, Kolegji çmon se pretendimi i kërkuesit për cenimin e standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor është haptazi i pabazuar.

### *C. Për pretendimin e cenimit të parimit të prezumimit të pafajësisë*

23. Kërkuesi ka pretenduar se mënyra e arsytimit të vendimeve të gjykatës së apelit dhe Gjykatës së Lartë krijojnë dyshimin se procesi gjyqësor në gjykatën e apelit ka filluar me bindjen se kërkuesi e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet. Në arsyetimin e vendimit të saj gjejnë vend vetëm provat e cilësuar prej saj si prova fajësie dhe nuk është shprehur për provat e tjera të pretenduara nga mbrojtja, duke rënë ndesh me parashikimin e neneve 8/a dhe 152 të KPP-së. Sipas mendimit të pakicës së trupit gjykues të gjykatës së apelit, organi i akuzës nuk ka arritur të provojë akuzën ndaj kërkuesit. Organi i prokurorisë ka paraqitur plotësim ankimi, përmbajtja e të cilit hedh dyshime për kryerjen e veprës penale prej kërkuesit. Kjo shprehet në kërkesën e organit të akuzës, ku me pretendimin se ka shkelje procedurale ka kërkuar prishjen e vendimit dhe kthimin e akteve



gjykatës për rigjykim dhe nëse kjo nuk pranohej, kërkohet ndryshimi i vendimit. Kërkuesi ka bërë kallëzim tek organi i prokurorisë, duke dhënë informacion të mjaftueshëm për marrjen e një personi konkret si të pandehur. Në vend që të mbrohej nga ligji, kërkuesi është konsideruar kriminel dhe është marrë në përgjegjësi penale.

24. Sipas nenit 30 të Kushtetutës, kushdo quhet i pafajshëm përderisa nuk i është provuar fajësia me vendim gjyqësor të formës së prerë. Në jurisprudencën e Gjykatës është pranuar se parimi i prezumimit të pafajësisë ka kuptimin që gjykatat e zakonshme nuk duhet ta fillojnë procesin me bindjen se i pandehuri e ka kryer krimin për të cilin akuzohet, se barra e provës i takon palës akuzuese, se çdo dyshim duhet të shkojë në favor të të pandehurit dhe se gjykata duhet ta mbështesë vendimin në prova të drejtpërdrejta dhe të tërthorta që duhet të provohen nga akuza. Parimi i prezumimit të pafajësisë kërkon që deklarimi i fajësisë së të pandehurit të bëhet nga gjykata vetëm pas një shqyrtimi të plotë të çështjes, në përputhje me parimin e kontradiktoritetit dhe të barazisë së armëve në gjykim (*shih vendimet nr. 13, datë 24.04.2018; nr. 68, datë 14.11.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

25. Në rastin në shqyrtim, nga përmbajtja e vendimit të Gjykatës së Apelit Durrës rezulton se gjatë shqyrtimit gjyqësor janë administruar prova dhe janë pyetur një sërë dëshmitarësh, si dhe janë dhënë arsyet se përse gjykata ka arritur në përfundimin se kërkuesi është deklaruar fajtor. Në gjykim është provuar kryerja e veprës penale për të cilën ai akuzohet, si dhe arsyetohet pse ajo gjykatë ka krijuar bindjen për fajësinë e tij. Gjithashtu, gjykata e apelit ka analizuar dhe vlerësuar pretendimet e kërkuesit, si dhe provat e paraqitura në gjykim. Prandaj Kolegji vëren se kjo gjykatë e ka deklaruar fajtor kërkuesin mbi një sërë provash të administruara në gjykim dhe të shqyrtuara e vlerësuara prej saj në tërësi dhe në harmoni me njëra-tjetrën dhe nuk rezulton që ajo të ketë arritur në një konkluzion *apriori* për fajësinë e tij.

26. Për sa më lart, referuar standardeve të mësipërme, si dhe arsytimit të vendimeve të gjykatave, Kolegji çmon se nuk rezulton që këto të fundit të kenë nisur procesin me paragjykimin dhe prezumimin se kërkuesi është fajtor për kryerjen e veprës penale për të cilën është gjykuar. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se edhe pretendimi për cenimin e parimit të prezumimit të pafajësisë është haptazi i pabazuar.

27. Në përfundim, Kolegji çmon se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për pranimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

## **PËR KËTO ARSYE,**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronjat “d” dhe “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

**V E N D O S I:**

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.